

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7988
E hënë, 10 shkurt 2025
Çmimi 0.50

PDK-ja shpreh shqetësim
pas paralajmërimit
për rritjen e çmimit
të energjisë elektrike | FAQE 4



REPUBLIKA E KOSOVËS KA MBAJTUR TË DIELËN ZGJEDHJET PARLAMENTARE

LV-ja PËSON RËNIE TË VOTAVE, MEGJITHATË DEL E PARA. PDK-ja E DYTA | FAQE 4-5



Sipas rezultateve preliminare të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje ka siguruar 40.4 për qind të votave, Partia Demokratike e Kosovës 21.7 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës 17.5 për qind të

votave, Koalicioni i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës 7.2 për qind të votave, Koalicioni për Familje ka siguruar 2.4 për qind të votave. Në këto përqindje nuk përfshihen votat e diasporës dhe ato me kusht. Komisioni

Qendor i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare ka qenë 40.59 për qind. Të drejtë vote në këto zgjedhje kanë pasur 1,970,944 qytetarë, ku nga ta votuan 799,954 qytetarë

KOSOVA NË UDHEKRYQ ME ALEATËT | F.7



BE-ja PËRSËRI
I KERKON
SERBISË T'I
SJELLË PARA
DREJTËSISË
PËRGJEGJËSIT
PËR SULMIN
NË BANJSKË | F.6



RENOVA
PUTZ
Magedoni Xheçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@m.t.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AKTUALE



TRUMPI THOTË SE BISEDOI ME PUTININ PËR UKRAINËN | F.2

USHTRIA ISRAELITE TËRHIQET NGA KORRIDORI NETZARIM QË NDANTE NË MES RRIPIN E GAZËS | F.2

Vendet baltike lidhen me rrjetin energetik evropian pas shkëputjes nga rrjeti rus | F.2



MAQEDONI E VERIUT: ÇFARË DO TË PËRFITOJNË QYTETARËT DHE BIZNESET NGA SISTEMI I PAGESAVE NË EURO | F.7

RRITJA E ÇMIMEVE, KOSOVA BËHET PJSË E BOJKOTIT TË SUPERMARKETeve | F.7



DRITA DHE BALLKANI FITOJNË NDESHEJET E PARA TË EDICIONIT PRANVEROR | F.8

Trumpi thotë se bisedoi me Putinin për Ukrainën

UASHINGTON, 9 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, tha se ka biseduar me presidentin rus, Vladimir Putin, për, siç raportohet, mënyrat për t'i dhënë fund pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës.

Në një intervistë të publikuar më 8 shkurt nga gazeta "The New York Post", Trumpi nuk tregoi se kur u zhvillua biseda, as përmbytjen e saj.

"The Post" tha se intervista u realizua më 7 shkurt derisa Trumpi po udhëtonte me avionin presidencial, Air Force One. "Ai dëshiron të mos shohë më njerëz duke vdekur", citohet të ketë thënë Trump. "Çdo ditë njerëzit po vdesin. Kjo luftë është aq e keqe në Ukrainë. Unë dua t'i jap fund kësaj gjëje të mallkuar", tha ai.

Kur u pyet se sa herë kishin folur dy udhëheqësit, ai u përgjigji: "Më mirë të mos e them". "Unë kam pasur gjithmonë një marrëdhënie të mirë me Putinin", tha ai.

"Radio Evropa e Lirë" dërgoi një email në Shtëpinë e Bardhë, duke kërkuar konfirmimin e raportit, por nuk mori përgjigje të menjëherëshe.



Në Moskë, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se është e mundur që dy liderët të kenë folur. "Ndërsa administrata në Uashington është duke kryer punët e saj, janë duke u shfaqur edhe me shumë lloje të ndryshme komunikimesh dhe këto komunikime bëhen përmes kanaleve të ndryshme", u tha Peskov gazetarëve më 9 shkurt. "Sigurisht, në sfondin e këtyre komunikimeve të shumta, unë, personalisht, mund të mos di diçka ose të mos jem në dijeni për diçka. Prandaj, në këtë rast nuk mund ta konfirmoj e as ta mohoj", shioi Peskov.

Edhe përpresa se ta merrte detyrën më 20 janar, Trumpi u zotua se do t'i jepte fund konfliktit në Ukrainë ku, sipas vlerësimave të Perëndimit, janë vrapë ose plagosur më shumë se 1 milion ushtarë nga të dyja palët. Ndihmësit kryesorë të Trumpit përsigurinë kombëtare kanë thënë publikisht se zyrtarët amerikanë do të përpilen ta nxisin Moskën dhe Kievin që të bisedojnë përmëpushim. I dërguari kryesor i Shtëpisë së Bardhë për Rusinë dhe Ukrainën, Keith Kellogg, pritet të takohet me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky në Konferencën e

Sigurisë në Munih, e cila hap punimet më 14 shkurt.

Më 7 shkurt Trumpi tha se ka të ngjarë të takohet me Zelenskyn javën e ardhshme. Ai nuk dha detaje të tjera, por tha se takimi mund të mbahet në Uashington, pasi "unë nuk do të shkoj në Kiev". Trumpi dha anëtarët e administratës së tij kanë dhënë pak detaje në lidhje me ndonjë propozim specifik përfundimin e luftës, por Kellogg tha së voni se të dyja palët do të duhet "të jepin pak", që do të thotë të bëjnë kompromise.

Ndërkohë, në Kiev, zyrtarët ukrainas janë duke vëzhguar me kujdes rritjen e presionit përsigurinë kombëtare kanë thënë publikisht se zyrtarët amerikanë do të përpilen ta nxisin Moskën dhe Kievin që të bisedojnë përmëpushim.

Deri vonë Putini ka thënë se e konsideron Zelenskyn president të paligjshëm dhe se nuk do të negociojë me t'por, ndërkohë, e ka zbutur atë qëndrim. Raporti përi intervistën vjen përpresa takimit që pritet të zhvillojë zëvendëspresidenti amerikan J. D. Vance, me Zelenskyn, gjatë Konferencës së

Sigurisë në Munih. Zelensky ka shprehur besimin se Trumpi mund të bëjë presion mbi Putinin për t'i dhënë fund luftës, e cila ka nisur më 24 shkurt 2022. Në një pjesë të intervistës me "New York Post", Trumpi, po ashtu, tha se ai "do të donte të bëhej një marrëveshje me Iranin" për programin e tij bërthamor, me qëllim shmangjen e përfundimit të tensioneve me Teheranin.

Trumpi refuzoi të jepte ndonjë detaj se si do të dukej marrëveshja me Iranin.

Më 7 shkurt udhëheqësi suprem i Iranit, Ajatollah Ali Khamenei, e hodhi poshtë mundësinë e bisedimeve përsëritje bërthamore me Shtetet e Bashkuara, duke këmbëngulur se negociatat nuk do t'i trajtonin problemet e Iranit.

Trumpi nënshkroi më 4 shkurt një urdhër për ta rikthyer politikën e tij të "presionit maksimal ekonomik" ndaj Iranit, që synon t'i dëmtojë eksportet e tij të naftës dhe ta ngadalësojë programin e tij bërthamor, për të cilin Teherani pretendon se është për qëllime civile.

Vendet baltike lidhen me rrjetin energjetik evropian pas shkëputjes nga rrjeti rus

Uashington, 9 shkurt - Estonia, Letonia dhe Lituania thanë të dielën se kishin sinkronizuar me sukses sistemet e tyre të energjisë elektrike me rrjetin energjetik kontinental evropian, një ditë pas ndërprerjes së lidhjeve të vjetra energjetike me Rusinë dhe Bjellorusinë. E planifikuar për shumë vjet, shkëputja komplekse nga rrjeti energjetik ish-sovjetik synon ta thellonte integrimin e tre vendave baltike me Bashkimin Evropian dhe ta riste sigurinë energjetike të rajonit. "Ne ia dolëm!", tha presidenti letonez Edgars Rinkevics në një postim

në rrjetin social X. Pas shkëputjes të shtunën nga rrjeti "IPS/UPS", i krijuar nga Bashkimi Sovjetik në vitet 1950, që tani menaxhohet nga Rusia, vendet baltike ndërprenë linjat e transmetimit të tensionit të lartë ndërkufitar në Letoninë lindore, rreth 100 metra nga kufiri rus. Shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, Kaja Kallas, vetë një estoneze, më herët këtë javë e quajti këtë ndryshim "një fitore përlirimë dhe unitetin evropian". Rajoni i Detit Baltik është në gatishmëri të lartë pas ndërprerjeve të kabilave të energjisë, lidhjeve të telekomit

dhe tubacioneve të gazit midis Baltikut dhe Suedisë dhe Finlandës. Të gjitha besohej se ishin shkaktuar nga anijet që tërhiqnin spiranca përgjatë shratit të detit pas fillimit të sulmit në shkallë të gjérë nga Rusia në Ukrainë. Rusia ka mohuar akuzat përfshirje në këto incidente.

Polonia dhe vendet baltike dislokuan mjete të marinës, njësi policore elitare dhe helikopterë pasi një linjë nënëjore e energjisë, që lidh Finlandën me Estoninë u dëmtua në dhjetor, ndërsa ushtria e Lituanisë filloj stërvitjet për t'i mbrojtur linjat tokësore me Poloninë.

Analistët thonë se dëmtimi i linjave energjetike mund të shkaktojë rritje të çmimit të energjisë elektrike në vendet baltike në nivele që nuk janë parë që nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë, kur çmimet e energjisë u rritën në nivel të

lartë. Rrjeti "IPS/UPS" ishte lidhja përfundimtare e mbetur me Rusinë për të tre vendet baltike, të cilat fituan pavarësinë në fillim të viteve 1990 pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe në vitin 2004 u bënë anëtare të Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Tre mbështetësit e fortë të Kievit ndaluan blerjet e energjisë nga Rusia pas fillimit të sulmit në shkallë të gjérë të Moskës kundër Ukrainës në vitin 2022, por janë mbështetur në rrjetin energjetik rus për t'i stabilizuar rrjetet e tyre energjetike dhe përt shërbimtarët.

Ushtria izraelite tërhiqet nga korridori Netzarim që ndante në mes Rripin e Gazës

Jerusalem, 9 shkurt - Ushtria izraelite ka njoftuar të dielën se kishte vrarë disa militante dhe kishte arrestuar disa të kërkuar në Nur Shams të Bregut Perëndimor, në kuadër të zgjerimit të një operacioni ushtarak në këtë territor. Ndërkohë, zyrtarët izraelitë thanë se forcat e tyre janë tërhequr nga një korridor kyç i Gazës, pjesë e angazhimeve të Izraelit në bazë të një marrëveshjeje armëpushimi me grupin militant të Hamasit. Ndërsa zhvillimi i së

dielës sinjalizon se marrëveshja po ecën përpresa, palët duket se kanë bërë pak përparym në negocimin e fazës së dytë të marrëveshjes, që synon ta zgjasë armëpushimin dhe të çojë në lirimin e më shumë pengjeve. Ushtria izraelite është tërhequr nga një zonë e Gazës, e njohur si korridori "Netzarim" që ndante këtë territor në mes, një veprim që pritej sipas marrëveshjes së armëpushimit midis Izraelit dhe Hamasit. Kjo u konfirmua

nga grupe militantë të Hamasit që kontrollon Rripin e Gazës. Më vonë një burim izraelit i sigurisë që foli në kushtet anonimiteti konfirmoi se ushtria izraelite po tërhiqet nga pozicionet e saj në Gazën qendrore. "Forcat izraelite e kishin zgogluar më herët praninë e tyre në atë zonë", tha zyrtari izraelit. Hamasi e festoi tërheqjen si një fitore dhe forcat e tyre u vendosën në zonë për ta menaxhuar rrjedhën e kalimit të palestinezëve.



Kosova në udhëkryq me aleatët

Në kohën e zhvillimeve të shpejta gjeopolitike është thelbësore që Kosova të rreshtohet me aleatët ndërkombe tarë. Dështimi për ta bërë këtë, rrezikon ta shtyjë vendin në izolim ose ta lërë të bllokuar në një konflikt të ngrirë, thonë zgjedhuesit në ShBA dhe Evropë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Për kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, asnjë qeveri e vendit nuk i ka pasur marrëdhëniet e mira me ShBA-në siç i ka pasur qeveria e tij. Po ashtu, shteti i Kosovës nuk ka përfituar kurrë më shumë nga bashkëpunimi me ShBA-në sesa gjatë qeverisjes së tij. "Qeveritë e mëhershme i përdornin raportet me ShBA-në e Perëndimin për pushtet, për karriget e tyre, për t'u ngjitur pak më lart e për të ndenjur pak më gjatë. Ne i përdorim përshtet, jo për pushtet, por për ta ngjitur shtetin lart e më lart dë për të qëndruar fuqishëm e fort në këmbët e veta", tha Kurti. Ai iu drejtua kështu mbështetësve në Ferizaj një javë para zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë.

Një ditë pas adresimit të tij, i dërguari i ShBA-së përmisione të posaçme, Richard Grenell, shkroi në rrjetin X se qeveria e Kurtit "nuk është partnerë e besueshme".

Edhe republikanët, edhe demokratët, sipas tij, e kanë kritikuar vazhdimisht Kurtin për ndërmarrjen e veprimeve të njëanshme, që destabilizojnë rajonin. "Retorika që përdor Kurti tani, duke pretenduar se është i afërt me ShBA-në dhe më i mirë se të gjitha qeveritë e tjera të Kosovës, është absolutisht e rreme", shkroi Grenell në X.

Kabineti i Kurtit nuk iu përgjigji kërkuesës së "Radios Evropa e Lirë" në lidhje me këto komente, por duke folur për një medium në Kosovë, ai përsëriti se marrëdhëniet me ShBA-në janë në nivelin më të mirë - në çka reagoi sërisht Grenelli, duke thënë se ato nuk kanë qenë kurrë në pikë më të ulët.

Kurti dhe qeveria e tij janë kritikuar edhe nga zyrtarë të administratës së mëparshme amerikane për veprimet, që janë cilësuar si të pakoordinuara, në veriun e Kosovës. Në këtë zonë të banuar me shumicë serbe, Qeveria e Kosovës ka zëvendësuar targat serbe me targa të Kosovës, ka hequr nga përdorimi dinarin serb, ka mbyllur institucionet paralele serbe të tjerë.

Për zyrtarët amerikanë, por edhe ata të Bashkimit Evropian, të gjitha këto e kanë vështirësuar jetesën e komunitetit serb dhe është dashur të diskutohen në kuadër të dialogut me Serbinë për normalizimin e marrëdhënieve.

Për Kurtin kanë qenë hapa të domosdoshëm drejt shtrirjes së sundimit të ligjit në veri dhe në përpunje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Kurti nuk është zmbrapsur as kur ShBA-ja e ka paralajmëruar



për rrezikim të raporteve, as kur BE-ja e ka ndëshkuar Kosovën me pezullim fondesh dhe takimesh të nivelit të lartë. Kurti vazhdimisht ka këmbëngulur se marrëdhëniet me Perëndimin janë të mira, edhe pse nuk ka pajtim përgjithçka. Por, për kundërshtarët e tij nuk është kështu. Kosova që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 nuk ka qenë kurrë në një pozicion më të pavolitshëm me partnerët ndërkombe tarë, sipas rivalëve të Kurtit që synojnë postin e kryeministrit. Secili prej tyre - Bedri Hamza i PDK-së, Lumir Abdixhiku i LDK-së dhe Ramush Haradinaj i AAK-së - e kanë pjesë të programit riparimin dhe thellimin e marrëdhënieve me ShBA-në sepse, sipas tyre, ato janë thelbësore përtë ardhmen e Kosovës.

Charles Kupchan nga Këshilli përmarrëdhënie me Jashtë në ShBA thotë se kushdo që e formon Qeverinë e ardhshme të Kosovës duhet të kujdeset që marrëdhëniet me ShBA-në të mbeten të forta dhe të paprekura.

Me të gjitha krizat në botë dhe me presidentin Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, Kupchan thotë se Kosova s'e ka luksin të jetë në mosmarrëveshje me aleatët. Si ajo ashtu dhe Serbia duhet ta kenë prioritet ekskluziv gjetjen e një rruge që çon në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, e jo në tensione të reja, sipas tij. "Palët e përfshira - Beograd dhe Prishtina - duhet të jenë të

kujdeshme ndaj hapave që Trumpi mund t'i shohë si të padobishëm. Trumpi nuk i pret mirë politikat që mendon se janë pengesë drejt marrëveshjes apo paqes", thotë Kupchan për programin Expose të "Radios Evropa e Lirë".

Kupchan e përshkruan Trumpin si njeri të marrëveshjeve, që i jep përparsi rezultatit dhe jo ideologjisë. Ndaj, thotë se Qeveria e Kosovës mund dë duhet të adoptojë një qasje më pragmatike. "Nëse dëshironi marrëdhënie të mira me Shtetet e Bashkuara, bëni marrëveshje, futuni në pazar, jini gati përtë negociuar. Ju duhet ta shihni Trumpin si një president që nuk është ideologjik, nuk mendon përhistorinë e luftërave në Ballkan, nuk ka ndonjë pikëpamje të veçantë përmarrëdhënie me Jashtë në ShBA thotë se kushdo që e formon Qeverinë e ardhshme të Kosovës duhet të kujdeset që marrëdhëniet me ShBA-në të mbeten të forta dhe të paprekura.

Me të gjitha krizat në botë dhe me presidentin Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, Kupchan thotë se Kosova s'e ka luksin të jetë në mosmarrëveshje me aleatët. Si ajo ashtu dhe Serbia duhet ta kenë prioritet ekskluziv gjetjen e një rruge që çon në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, e jo në tensione të reja, sipas tij. "Palët e përfshira - Beograd dhe Prishtina - duhet të jenë të

vendimtar në qasjen e BE-së ndaj Kosovës. "Gjermania ka qenë shumë e afërt me Vuçiqin, me liderët serb dhe ka zhvilluar lidhje gjithnjë e më të forta ekonomike me Serbinë. Pra, nuk ka asgjë që mund të bëjë Kosova përtë balancuar këtë. Ajo nuk duhet të ketë iluzione, por duhet ta dijë se është më e dobët edhe politikisht, edhe ekonomikisht, edhe në aspektin diplomatik. Por, e gjithë kjo e bën më të rendësishme përtë, që të ketë marrëdhënie më të ngrohta dë më korrekte diplomatike me aleatët kryesorë", thotë Vogel përi Exposenë.

Vogel e këshillon Qeverinë e ardhshme të Kosovës që të shmangë çdo hap të pakoordinuar, sidomos kur bëhet fjalë përtë pjesën veriore të vendit.

Shfaqja e përbajtjes dhe prioritizimi i zgjidhjeve diplomatike do ta forconin pozitën e Kosovës edhe në negociatat e saj me Brukselin, edhe në ato me Beogradin, sipas tij. "Ka shumë pasiguri dë lundrimi në këtë ujëra shumë të trazuar do të kërkojë shumë aftësi. Por, unë mendoj se ka shanse dhe ato duhen shfrytëzuar. Një prej tyre është ndërrimi i udhëheqësve të Bashkimit Evropian. Tani kemi një përfaqësuese të re të politikës së jashtme e cila mbikëqyr dialogun mes Kosovës dhe Serbinë. Dhe, ajo nuk është dashamirëse ndaj Rusisë apo ndikimit rus në Ballkan", thotë Vogel.

"REL"-i pyeti Bashkimin Evropian nëse është duke shqyrtuar heqjen e masave kundër Kosovës dhe çfarë hapash specifikë pret BE-ja nga Kosova përtë bërë një gjë të tillë.

Në përgjigjen e marrë nga një zëdhënës i BE-së thuhet se "masat e përkohshme të BE-së janë të kthyeshme dhe Këshilli tashmë ka vendosur kushte përtë heqjen graduale të tyre, të cilat lidhen me marrjen e hapave që i ulin tensionet në veri".

Në qarqet e BE-së kjo përgjigje është përfolur qysh në qershor të vitit të kaluar por, ndërkohë, Qeveria e Kosovës ka vazduar aksionet e veta, duke mbyllur sidomos institucione që funksionin brenda sistemit të Serbisë jo vetëm në veri, por edhe në komuna të tjera me shumicë serbe.

Vogel thotë se qasja e tillë nuk është e duhura - mund ta lëre Kosovën të izoluar dhe jo vetëm. "Çfarë unë kam frikë se mund të ndodhë, është një situatë si ajo që është zhvilluar, për shembull, në Qipro gjatë viteve. Pra, një lloj konflikti i ngrirë që nuk shpërthen në dhunë - edhe pse sulmi në Banjskë ka dëshmuar edhe të kundërtën. Ndaj, Kosovës nuk i duhen aso fluskash të vazduhesme nën sipërfaqe, sepse do ta pengonin përtë ecur përpara, përtë u bërë anëtarë e Këshillit të Evropës e kështu me radhë", thotë Vogel.

Kosova tani është në pritje të qeverisë së re që do të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Varësish rezultatit, në tryezë mund të jenë kombinime në ndryshme. Kurti ka dhënë sinjalë se, nëse fiton mandatin e ri si kryeministër, ai do të vazhdojë ta forcojë imazhin e tij si një udhëheqës i pakompromis, i cili i jep përparsi parimit përpara diplomacisë. "Republika e Kosovës, me qeverinë tonë në udhëheqje, i thotë jo kurrë 'zajednicës' dë po asocianonit të komunave të Kosovës", ka thënë Kurti në një tubim me mbështetësit në Mitrovicë të Jugut.

Me "zajednicë", partia e Kurtit i është referuar vazhdimisht Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Formimi i këtij asociacioni ka qenë pjesë e një marrëveshjeje që Kosova e ka arritur me Serbinë në vitin 2013, por që nuk është zbatuar kurrë.

Pavarësish trysnisë së aleatëve perëndimorë përtë qear përpara, Kurti nuk ka bërë asnjë hap në atë drejtim.

Por, me fjalët e Kupchanit, politika është e paparashikueshme dë, pas zgjedhjeve, gjithçka mund të marrë kthesë të re... sepse nëse ka një gjë të sigurt në politikë, është se asgjë nuk është kurrë e sigurt.



REPUBLIKA E KOSOVËS KA MBAJTUR TË DIELËN ZGJEDHJET PARLAMENTARE

LV-ja pëson rënie të votave, megjithatë del e para. PDK-ja e dyta

Sipas rezultateve preliminare të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, Lëvizja Vetëvendosje ka siguruar 40.4 për qind të votave, Partia Demokratike e Kosovës 21.7 për qind të votave, Lidhja Demokratike e Kosovës 17.5 për qind të votave, Koalicioni i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës 7.2 për qind të votave, Koalicioni për Familje ka siguruar 2.4 për qind të votave. Në këto përqindje nuk përfshihen votat e diasporës dhe ato me kusht. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare ka qenë 40.59 për qind. Të drejtë vote në këto zgjedhje kanë pasur 1,970,944 qytetarë, ku nga ta votuan 799,954 qytetarë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka njoftuar se pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare ka qenë 40.59 për qind. Të drejtë vote në këto zgjedhje kanë pasur 1,970,944 qytetarë, ku nga ta votuan 799,954 qytetarë. Këto janë zgjedhjet e para të rregullta parlamentare që organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Procesi i votimit ka shkuar në

rregull, me pak probleme të vogla. Zyrtarët zgjedhorë deri në orën 23:30 kanë vazhduar numërimin e votave. Ndërkaq rezultatet preliminare i ka dhënë edhe Demokracia në Veprim, rrjet i organizatave që monitoron zgjedhjet në Kosovë. DnV-ja ka bërë me dije se pjesëmarrja në zgjedhje ishte 42.1 për qind, me marginë gabimi prej 0.84%. Votat me kusht dhe ato nga diaspora nuk janë përfshirë në këtë llogaritje.

Sipas DnV-së, Lëvizja Vetëvendosje ka siguruar 40.4 për qind të votave, me marginë gabimi 1.44%. Partia Demokratike e Kosovës ka siguruar 21.7 për qind të votave, me marginë gabimi 1.45%. Lidhja Demokratike e Kosovës ka siguruar 17.5 për qind të votave, me marginë gabimi 0.97%. Koalicioni i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës ka siguruar 7.2 për qind të votave, me marginë gabimi 0.82%.

Koalicioni për Familje ka siguruar 2.4 për qind të votave, me marginë gabimi 0.21%. Lista Serbe ka siguruar 5.4 për qind të votave, me marginë gabimi 1.68%.

Subjekti serb, Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë ka siguruar 0.6 për qind të votave. "Votat jashtë vendit dhe ato me kusht mund të kenë ndikim deri në një shkallë prej 5% te subjektit politike", tha Eugen Cakolli nga DnV-ja.

Kandidatët për kryeministër janë në këto zgjedhje janë Albin Kurti nga LV-ja, Bedri Hamza nga PDK-ja, Lumir Abdiçhiku nga LDK-ja dhe Ramush Haradinaj nga koalicioni AAK-Nisma dhe partnerët e tjerë.

Tetë persona të ndaluar për vepra penale kundër të drejtave të votimit

Prokuroria e Shtetit bëri të ditur se, ditën e zgjedhjeve, janë ndaluar 8 persona për vepra penale kundër të drejtave të votimit. "Gjatë ditës së sotme, Prokurori i Shtetit ka

pranuar disa informata dhe pas verifikimit të tyre deri në mbyllje të procesit të votimit, janë hapur katër raste kundër tetë personave, kurse informatat tjera janë duke u trajtuar", thuhet në njoftimin për mediat.

**Policia e Kosovës:
Procesi zgjedhor kaloi i qetë dhe pa incidente serioze**

Policia e Kosovës vlerësoi se procesi zgjedhor më 9 shkurt ka kaluar i qetë dhe pa ndonjë incident madhor, që do ta cenonte atë. Ajo tha se plani i saj operacional, i paraparë përmbarëvajtjen e procesit zgjedhor, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve, "është realizuar me sukses në tërë territorin e Republikës së Kosovës".

Në një komunikatë përmëdia, Policia po ashtu bëri të ditur se, në bashkëpunim dhe koordinim me Prokurorinë e Shtetit, ka iniciuar gjashtë raste - prej tyre katër për vepra penale kundër të drejtave të

votimit dhe dy për sulme ndaj personit zyrtar dhe kanosje. "Janë trajtuar edhe disa raste të tjera, të cilat në bashkëpunim dhe koordinim me prokurorët kompetentë, janë evidentuar si shënimë zyrtare", tha Policia e Kosovës.

DnV-ja raporton për disa probleme gjatë procesit të votimit

Koalicioni i organizatave joqeveritare, Demokracia në Veprim, ka raportuar për disa probleme gjatë procesit të votimit për zgjedhjet parlamentare.

Eugen Cakolli nga DnV tha se votuesit kanë deklaruar se ngjyra matrikuluese po fshihet lehtësisht nga gishtërinjtë e tyre dhe kjo çështje sipas tij mund t'i japë rrugë votimit të dyfishtë.

Një gjë e tillë, sipas Cakollit, "do minonte besimin e publikut, por edhe integritetin zgjedhor". Në konferencën për media, Cakolli tha se ka disa mekanizma që sigurohet që votuesit të mos votojnë dy herë, por theksoi se "problemi te fakti fshirja e lehtë e ngjyrës matrikuluese mund të krijojë perceptim qytetarë procesi nuk ka qenë i rregullt dhe mund të ketë pasur raste të tillë".

Gjatë konferencës, DnV-ja tha se ka vërejtur edhe probleme të tjera gjatë procesit zgjedhor, që tha se nuk dëmtojnë integritetin e zgjedhje.

Problemi më i theksuar gjatë procesit të votimit deri në mesditë, sipas Cakollit është mosqjetja e emrave të votuesve në listat e votuesve.

DnV ka 500 vëzhgues në mbarë vendin dhe Cakolli tha se janë vërejtur edhe probleme kur nuk është regjistruar që një votuesit i është ofruar asistencë me votim.

Po ashtu, ndonëse në një nivel dukshëm më të vogël, Cakolli tha se edhe në këto zgjedhje

fenomeni i fotografimit të votës është prezant dhe thanë se raste të izoluara të fotografimit të votave janë regjistruar në 4 për qind të vendvotimeve.

Cakolli po ashtu u shpreh kritik për çështjen e vendosjes së kabinave të votimit. Ai tha se në mëngjes kabinet u vendosën sipas rregullave, por vëzhguesit më pas kanë hasur në raste kur persona të identifikuar si staf i KQZ-së kanë kërkuar që kabinet të vendosen përballe njëra-tjetrës, që sipas tij përbën shkelje të privatësisë.

Kurti: Jemi të parët, do ta formojmë qeverinë e re

Në orët e vona të së dielës, kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje, Albin Kurti, ka mbajtur një konferencë për medie pas përfundimit të zgjedhjeve. Në fjalën e tij, Kurti tha se procesi zgjedhor ishte i lirë, demokratik

dhe i ndershëm, duke e cilësuar rezultatin si një konfirmim për qeverisjen e tij. "Jemi të parët, ky është një konfirmim për qeverisjen tonë të mirë, demokratike dhe progresiste. Koalicioni ynë fitues do ta formojë qeverinë e re", tha ai.

Kurti theksoi se do të vazhdojnë me punët e nisura, duke shtuar se qytetarët kanë treguar se janë kundër oligarkëve. "Kemi pasur pretime absurdë nga opozita, të cilat kanë krijuar një atmosferë irrationale", u shpreh ai.



Palokaj: Pakicat mund të vendosin për Qeverinë e re

Augustin Palokaj, gazetar që prej vitesh përcjell politikat e Bashkimit Evropian, pret që Lëvizja Vetëvendosje ta kalojë shifrën prej 40% të votave.

Duke folur për Radion Evropa e Lirë, ai thotë se pakicat mund të vendosin se kush do ta formojë Qeverinë e re, nëse Vetëvendosje nuk bën koalicion me ndonjë parti opozitare. "Besoj që Vetëvendosje si parti fituese do të jetë ajo që do ta marrë mandatin

për të tentuar ta themelojë Qeverinë. Na pret një situatë jo e lehtë me turbulencia të mundshme politike në Kosovë, por edhe në skenën ndërkombëtare", thotë Palokaj. BE-ja ka në fuqi disa masa ndëshkuese kundër Kosovës, për shkak të tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe.

Palokaj thotë se, pas zgjedhjeve dhe pjesëmarrijes së komunitetit serb në to, pret që BE-ja t'i heqë ato. "Tash tensione në veri, përfat të mirë, nuk ka dhe nuk shoh arsyë që të mos hiqen masat. Pra, mbeten

vetëm disa aspekte ligjore se si të hiqen gradualisht ato", thotë Palokaj.

Sa i përket dialogut për normalizimin e marrëdhënive mes Kosovës dhe Serbisë, ai pret që BE-ja ta vazhdojë presionin mbi Kosovën për themelin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Ai, po ashtu, pret që BE-ja ta vlerësojë me notë të lartë rrjedhën e procesit zgjedhor. Politologu Dritëro Arifi thotë se rezultatet jozyrtare të zgjedhjeve tregojnë se Lëvizja Vetëvendosje mund ta ketë të vështirë formimin e Qeverisë e


vetme. Sipas tij, rezultatet jozyrtare janë një sinjal për partinë në pushtet, se duhet të punojë më shumë dhe të mos mbështetet vetëm në fjalë.

Osmani: Të mbrohet integriteti i procesit zgjedhor, duke siguruar që çdo votë të numërohet saktë

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka përgëzuar qytetarët që, edhe në këtë proces zgjedhor, treguan kulturën e lartë demokratike. Ajo ka shprehur pritshmërinë që KQZ-ja do të përfundojë me sukses numërimin e votave brenda mbrëmjes së diel.

Megjithatë, pas dëshimit të softuerit, informacion ky i konfirmuar nga KQZ-ja, presidentja ka kërkuar që të mbrohet integriteti i procesit zgjedhor, duke siguruar që çdo votë të numërohet saktë.

Presidentja në deklaratën e saj për medie, ka theksuar se do të vazhdojë të jetë në kontakt me të gjitha institucionet përkatëse, deri në sigurimin e plotë që i gjithë procesi zgjedhor, përfshirë numërimin dhe publikimin e rezultateve, të zhvillohet në përputhje me standarde më të larta demokratike dhe në përputhje me vullnetin qytetar.



Rritja e çmimeve, Kosova bëhet pjesë e bojkotimit të supermarketave

PRISHTINË, 9 SHKURT - Në Kosovë nga dita e hënë një grup i qytetarëve pritet t'i bashkohen iniciativës për bojkotimin e supermarketave si rrjetohojë e rritjes së vazhdueshme të çmimeve.

Një iniciativë e tillë fillimisht u mor në disa vende të rajonit. Për këtë bojkot është krijuar edhe një grup nga qytetarët në rrjetet sociale të cilët bëjnë thirrje që më 10 shkurt ta mbështesin këtë nismë për bojkot në Kosovë. Sipas tyre, është koha e fundit që autoritetet përgjegjëse të reagonjë për situatën e krijuar me çmime të larta. Derisa të njëjtë shprehen se disa produkte bazike janë më lirë në vende të Evropës se në Kosovë. Këtë iniciativë e mbështesin edhe njohës të ekonomisë dhe Shoqata "Konsumatori". Kjo e fundit vlerëson se epoka e mashtrimeve dhe e çmimeve spekulitative ka mbaruar.

Më shumë detaje për këtë nismë ka dhënë për "KosovaPress", një nga themeluesit e iniciativës, Xhevati Kastrati, i cili ka theksuar se qëllimi kryesor është të krijuhet një platformë ku qytetarët mund t'i shprehin ankesat e tyre për çmimet e larta. Derisa nënvizon se ka pasur një kohë të gjatë që qytetarët janë ankuar për rritjen e çmimeve dhe se nuk kanë marrë reflektim nga përgjegjësit, thotë se kjo iniciativë ka për qëllim sensibilizimin e qytetarëve dhe të gjithë aktorëve të përfshirë që nuk mund të vazhdohet më me këtë situatë. "Ka çmime spekulative që nuk paraqesin vlerën reale të produktit. E kemi parë me shembuj të ndryshëm në grup që shumë produkte shiten shumë më shtrenjtë te ne sesa në shtetet e jashtme. Por, besoj se edhe qeveria e ardhshme duhet të bëjë diçka për ta



rregulluar lëvizjen e çmimeve. Po besoj se kemi me qenë shumë të bashkuar si qytetarë dhe të bëjmë më dije se derisa nuk ka ulje të çmimeve, nuk do

të dorëzohemi me bojkot. Po ashtu, dëshirojmë që së shpejti të kemi diskutim më të hapur edhe me organet kompetente", thotë Kastrati. Sipas tij, deri tash

janë rrith 5 000 persona të anëtarësuar në grupin "Kosova Bojkoton", porse mbështetje pret edhe nga një masë më e gjërë.

BE-ja përsëri i kërkon Serbisë t'i sjellë para drejtësisë përgjegjësit për sulmin në Banjskë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Bashkimi Evropian (BE) i ka bërë sërisht thirrje Serbisë të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për t'i sjellë para drejtësisë përgjegjësit e dyshuar për sulmin vdekjeprurës në fshatin Banjskë në veri të Kosovës në vjeshtën e vitit 2023. "Ne e kemi marrë parasysh paralajmërimin e zyrës së prokurorit të lartë në Beograd më 2 dhjetor 2024 për hapjen e hetimeve në këtë rast", tha një zëdhënës i bllokut. Ai shtoi se Serbia është e detyruar të bashkëpunojë në hetimet përrastin e Banjskës.

Më 24 shtator 2023 një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit, duke vrarë një polic të Kosovës. Gjatë këmbimit të zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Kosova e fajëson Serbinë përkëtë sulm, e cila mohon përfshirjen.

Përgjegjësinë për sulmin e mori



Millan Radoiqiq, ish-nënkyretar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë që gjëzon mbështetjen e Beogradit. Në shtator të vitit të kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës ngriti aktakuzën ndaj 45 personave - në mesin e tyre edhe Millan Radoiqiq - për sulmin e armatosur në Banjskë.

Autoritetet në Serbi nuk pranojnë ta ekstradojnë Radoiqiqin në Kosovë dhe thonë se ai do të gjykohet nga "gjykatat serbe", ndërsa zyrtarët në Kosovë thonë se ato i kanë ofruar mbrojtje atij.

Në dhjetor, kryeprokurori i Prokurorisë së Lartë Publike në Beograd, Nenad Stefanovic, tha

se vendimi për të ngritur aktakuzë kundër Radoiqiqit do të merrej deri në fillim të vitit 2025. Në Serbi, Radoiqiqi dyshohet për vepra të tjera penale, përkatesisht për "krim të rëndë kundër sigurisë së përgjithshme dhe prodhim, mbajtje dhe trafik të paligjshëm të armëve".

Ndërkohë zëdhënësi i BE-së e

përsëriti të premten se për Serbinë përparimi në bisedimet për anëtarësim në bllokun evropian do të varet edhe nga përparimi në normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën dhe nga sundimi i ligjit. Vendet anëtarë të BE-së në dhjetor nuk ishin pajtuar se Serbia i ka përbushur të gjitha kushtet për të hapur disa kapituj në procesin e negociatave të anëtarësimit, edhe pse Komisioni Evropian kishte dhënë vlerësimin se ato kushte ishin përbushur nga ana e Beogradit.

Disa shtete anëtarë kundërshtimin për hapjen e këtyre kapitujve e kishin arsyetuar me mungesën e rezultateve në sjelljen para drejtësisë të atyre që janë përgjegjës për sulmin në Banjskë. Disa shtete të BE-së janë sidomos të pakënaqura me faktin se nuk ka ende as aktakuzë ndaj Radoiqiqit.

PDK-ja shpreh shqetësim pas paralajmërimit për rritjen e çmimit të energjisë elektrike

PRISHTINË, 9 SHKURT - Partia Demokratike e Kosovës ka reaguar pas paralajmërimeve se do të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike.

Zëdhënësi i kësaj partie, Blerand Stavileci, ka thënë se qytetarët nuk mund ta përballojnë edhe një barrë të re financiare. Para medieve, Stavileci ka thënë se Kosova po përballet me një rritje të

ndjeshme të kostos së jetesës. "Nuk mund të mos shprehim shqetësimin tonë për paralajmërimet për rritjen e çmimit të energjisë elektrike në këtë periudhë të krisës ekonomike. Kosova po përballet me një rritje të ndjeshme të kostos së jetesës në pesë vitet e fundit dhe qytetarët nuk mund të përballojnë edhe një barrë të re

financiare. Mjافت më me barra të paarsyeshme dhe të pandershme në kurriz të qytetarëve. PDK ka qenë dhe do të jetë gjithmonë në anën e qytetarëve, duke mbrojtur interesin e tyre dhe duke kundërshtuar vendimet që rëndojnë jetesën e familjeve të Kosovës si dhe duke punuar çdo ditë që ta përmirësojë standardin e tyre", u shpreh ai.



Maqedoni e Veriut: Çfarë do të përfitojnë qytetarët dhe bizneset nga sistemi i pagesave në euro

Aplikimi i Maqedonisë së Veriut në fushën unike për pagesa në euro – SEPA pritet që të miratohet së shpejti, kurse integrimi i plotë mund të ndodhë në tetor të këtij viti. Përfitimet për qytetarët, por edhe më shumë për bizneset, do të janë transaksionet më të shpejta, digitalizimi dhe qasja në tregun evropian, por më e rëndësishmja - shpenzimet më të ulëta

SHKUP, 9 SHKURT - Rrallëherë dërgoj para nga jashtë në xhirologarinë në Maqedoni të Veriut. Provizonet janë shumë të larta, për vetëm disa qindra euro, provizioni është rreth 7 euro, dhe është më mirë që me këto para të blej diçka për fëmijët. Kur kthehem, paratë i sjellim të gatshme dhe atje i mbajmë ose i dërgojmë nëpërmjet miqve që të na i depozitojnë në llogaritë tona bankare në Maqedoni të Veriut.

Kjo është praktika që përdor Kristina Nikolovska, një mërgimtare në Gjermani, për transfere të parave në vend. Mirëpo kjo mund të bëhet e kaluar për të dhe për të gjithë mërgimtarët dhe qytetarët që kryejnë transaksione dhe pagesa nga dhe për në vendet e huaja, pasi Maqedonia e Veriut po përgatitet të bëhet pjesë e Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA).

Kjo pritet të ketë leverdi të madhe edhe për kompanitë,

pasi do të shkurtohet edhe koha edhe shpenzimet për transaksionet në euro.

SEPA është iniciativë e BE-së që ka për qëllim thjeshtimin dhe standardizimin e transaksioneve, për të pasur pagesa dhe transfera më të shpejta, më të lira dhe më të sigurta në euro mes shteteve anëtare. Ajo përfshin të 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe Norvegjinë, Lihtenshtajnin, Zvicrën, Monakon, Islandën, San Marinon, Andorrën, Vatikanin dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Anëtarësimi në të është një nga priorititetet e përcaktuara në Planin për Rritjen Ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Mali i Zi dhe Shqipëria tashmë janë pranuar në këtë zonë, ndërsa Maqedonia e Veriut pritet të marrë së shpejti dritën e gjelber.

Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut ka paraqitur aplikimin në korrik të vitit 2024, ndërsa data e parë e mundshme për hyrjen e bankave nga Ballkani Perëndimor, përkatësisht për

përgatitjen e plotë për integrimin në SEPA, në praktikë, është tetori i vitit 2025, deklaroi guvernatorja Anita Angelovska-Bezhoska.

Sa do të kursejë rajoni nga transaksionet e qytetarëve?

Një metodë më e qasshme, më komode dhe më e sigurt për transaksionet në euro janë fjalët me të cilat nga Banka Popullore e Maqedonisë i përshkruajnë përfitimet që do të kenë qytetarët nga anëtarësimi në SEPA. Sipas kësaj banke, leverdia, para së gjithash, do të jetë në uljen e shpenzimeve për pagesat tejkufitare, përfshirë këtu edhe dërgesat. "Sipas analizës së Bankës Botërore për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, shpenzimet do të ulen ndjeshëm, duke bërë që ekonomitë të mund të kursejnë rreth gjysmë miliardi euro", thonë për Radion Evropa e Lirë (REL) nga Banka Popullore.

Pritjet janë që kjo do ta përshpejtojë edhe transformimin digital të sektorit financiar dhe do ta ulë varësinë nga transaksionet me para në dorë.

Biznesi pret një ulje drastike të shpenzimeve

Janë të mëdha pritet edhe të komuniteti i biznesit, i cili përmes kësaj do të ketë një qasje më të thjeshtë në tregun e BE-së. "Në praktikë duhet t'i ulë shpenzimet për pagesat në rajon dhe në BE. Për më tepër, kjo do të ndikojë edhe në shpejtësinë. Teorikisht, nëse tani duhen një ose dy ditë për të përfunduar transaksione, tani presim që, të paktën, ato të realizohen menjëherë", thotë për REL-in kryetari i Lidhjes së Odave Ekonomike, Trajan Angeloski.

Sektori i biznesit pret që të

ndikojë edhe në efikasitet. Siç

thotë Mile Boshkovi nga Konfederata e Biznesit të



Maqedonisë së Veriut, kompanitë që kanë aktivitete tregtare ndërkontinentale - shitje, blerje, shërbime konsulente etj., do të mund t'i bëjnë pagesat nga zyra dhe në lëvizje, dhe kjo është e rëndësishme për ta, sepse në biznes ka "situata të caktuara kur është e rëndësishme të shfrytëzohet momenti dhe sekonda e caktuar".

Sipas një analize të Bankës Botërore, që e theksojnë edhe nga Banka Popullore, tani, krahasuar me BE-në, shpenzimet për pagesat tejkufitare në euro për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Ballkanin Perëndimor janë rreth 12 herë më të larta për transferimin e 5 000 eurove dhe 15 herë më të larta për transferimin e 20 000 eurove.

Fund për "bankat korresponduese"

Ajo që theksojnë, si kompanitë, ashtu edhe Banka Popullore, është se i gjithë ky proces do t'i japë fund përdorimit të bankave korrespondente. "Hyrja në SEPA do të mundësojë qasje më të lehtë në sistemet e pagesave në BE, duke eliminuar nevojën për aranzhime të komplikuara dhe të shtrenjta korrespondente bankare. Ky thjeshtim do të çojë në pagesa më efikase, më të leverdishme dhe më të shpejta tejkufitare", thonë në Bankën Popullore theksojnë se deri tani është arritur një harmonizim i lartë i kërkuesave rregullatore në fushën e shërbimeve të pagesave, masave për parandalimin e pastrimit të parave, qarkullimit të lirë të kapitalit dhe mbrojtjes së të dhënave. Maqedonia e Veriut, theksojnë ata, ka përbushur kërkuesat teknike

tjetër, shpesh duhet të përdorin banka edhe në vende të treta. "Nëse duam të paguajmë, për shembull, në Suedi, duhet të shfrytëzojmë një bankë korresponduese që do ta realizojë këtë transferim në Gjermani ose në vende të tjera, pasi bankat tona nuk kanë komunikim direkt, për shembull, me disa banka nga Suedia ose Portugalia", shpjegon Boshkov.

Çfarë është bëre deri tani dhe çfarë duhet të bëhet?

Pavarësisht se përfitimet nga anëtarësimi në SEPA janë të qarta, duhet të pranojmë se na presin edhe sfida, porositi guvernatorja Angellovska-Bezhoska. Këto komente ajo i bëri gjatë pjesëmarrjes në një punëtori në Shkup lidhur me këtë temë, e ku të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Bankës Botërore, Bankës Qendrore Evropiane, Këshillit Evropian të Pagesave, Asociacionit Italian të Bankave dhe të tjerë.

Aplikimi i Maqedonisë së Veriut për SEPA duhet të miratohet nga Këshilli Evropian i Pagesave, kurse në Banka Popullore theksojnë se deri tani është arritur një harmonizim i lartë i kërkuesave rregullatore në fushën e shërbimeve të pagesave, masave për parandalimin e pastrimit të parave, qarkullimit të lirë të kapitalit dhe mbrojtjes së të dhënave. Maqedonia e Veriut, theksojnë ata, ka

dhe ligjore të SEPA-s dhe ajo që pritet tani është përfundimi i vlerësimit formal të aplikimit dhe gatishmërisë për anëtarësim.

Për harmonizimin e mëtejshëm të legjisacionit me atë të BE-së që kërkohet për anëtarësimin në SEPA, janë në procedurë parlamentare edhe ndryshimet e Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe Sistemet e Pagesave. Më 27 janar ato kaluan në leximin e dytë në komisionet përkatëse parlamentare. Megjithatë, për një integrim të plotë në këtë fushë, një rol kyç duhet të luajnë edhe bankat. "Në mënyrë që qytetarët dhe kompanitë t'i ndiejnë përfitimet nga SEPA, vendimtare do të jetë që bankat të janë operativisht të përgatitura dhe të bashkohen me skemat e SEPA-s (sistemet e pagesave) pas miratimit të aplikimit tonë. Ne gjatë këtij procesi do të sigurojmë mbështetje të plotë rregullatore për bankat", thonë nga Banka Popullore për REL-in.

Kohë më parë, për të mbështetur procesin e integrimit në SEPA të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Moldavisë, Drejtoria e Përgjithshme për Fqinqjësinë dhe Negociatat për Zgjerim e Komisionit Evropian, formoi edhe Komitetin Menaxhues. Në krye të këtij trupi është kreu i saj, Gert Jan Kopman, ndërsa pjesë e drejtorisë janë guvernatorët e bankave qendrore të rajonit, përfaqësues të BE-së, Bankës Botërore dhe të institucioneve të tjera financiare evropiane.

Brenda tekstit kutelian: Kërkimi i vdekjes si shpëtim dhe etje për amshim

Nga: Eduart BARDHI

Hermann Hesse dëshmonte se letërsia është mjet për krijimin e "mbretërive matanë kohës dhe iluzionit", ose "përjetësive".^[1] Pra, bota e saj mund ta nxisë krijimin e një "vizioni të përfjetësisë", të mbështetur në vlerat e përbotshme dhe të përfjetshme. Piktura mesjetare, ndërkaq, përmes tablove shumëngjyrëshe ka dëshmuar për ekzistimin e një mbretërie tjetër vlerash, atë të "bashkësisë së shenjtëve", frysëzues së madhe të letërsisë mbi të cilën janë krijuar disa shekuj letërsi. "Bashkësia e të shenjtëve" (ideja e Zotit), e kodifikuar në kujtesë përmes pikturës, përbën një paradigmë të dyfishtë: morale dhe sociologjike. Si paradigmë sociologjike, ndërkaq, ajo ka ndikuar në përbashkimin e njerëzve të cilët besojnë në një sistem vlerash. Religjioni, "mbretëria e të shenjtëve", kësicoj, përbën dhuratën që Mesjeta ia dhuroi njerëzimit: krijimin e bashkësisë religjioze, si përbashkësi, e cila i përafrom njerëzit mbi disa vlera të përbashkëta. Përbashkësia nënkupton kujtesën dhe jo përditshmérinë nga e cila priret besimi e veprimi. Letërsia e mesjetës, prandaj, e lidh nyjë kujtesën religjioze me vizionin për përbashkësinë në "mbretërinë e përfjetshme" të letave.

Bashkësia religjioze ndërtohet përmbi dy premisa të fuqishme: komunikimin dhe socializimin.^[2] Duke i përkthyer tekstet e vjetra fetare, autorët filobiblikë synonin që t'ua lehtësonin arbërorëve të krishterë njojen e mësimive të Zotit, duke i dëgjuar (më shumë se sa duke i lexuar) të kënduara në gjuhën e tyre. Kësicoj, ata e plotësonin kriterin e parë të përbashkësimit religjioz: komunikimin "në një gjuhë". Së dyti, ata synonin që duke i përkthyer tekstet fetare në gjuhën e besimtarëve të veriut (parimi regional a lokal është po kështu kriter i përbashkësisë), t'i mbanin ata "të lidhur për kishën". Nga ky lloj bashkërendimi u krijuar bashkësia etno-gjuhësore, e cila identifikohet me territorin (regional), gjuhën e kulturën. Pra, letërsia filobiblike, përvëç rolit utilitar, krijoj edhe përmasen e pjesshme të kombit (të paraformacionit kombëtar: etnisë). Ajo i dha shtysë identifikimit të një bashkësie, e cila duke e synuar homogenitetin religjioz, duke i zgjeruar format e komunikimit, si dhe duke e përcaktuar territorin regional, pjesëtarët e të cilët të socializoheshin me njëri-tjetrin, i paraprinx proçesit të mëvonshëm të formimit të kombit.

Letërsia shqipe e mëvonshme e

njohu këtë trashëgimi, duke e zhvilluar një tip letërsie e cila i referohet mitit religjioz mesjetar, sidomos në nivel të diskursit. Religioni depërtoi në forma të ndryshme në metashkrimin e letrave tona, krasa ndikimit spiritual që pati herë-herë - jo shkaku i konstruksionit të saj si realitet, sa shkaku i rrethanave historike dhe shoqërore. Shqiptarëve, duke ju rastisur që filozofinë e ekzistencializmit të tyre - për ironi - ta kenë pikërisht brenda religionit: ata ngelen me një letërsi të vonshme, me krijuesit e saj - sidomos të fillimletërsisë - klerikë.

Thelbi i religionit është mbinaturorja dhe një aspekt universal i saj është besimi në frysë, shpirtra dhe jetën pas vdekjes. Tylor e ndiente që besimi në një frysë brenda njeriut, kafshëve dhe, madje, brenda objekteve të pashpirt, përfaqësonte format më të hershme të religionit. Ai u zhvillua, siç besonte ai, nga ndërrat dhe përvroat e tjerë në lidhje me gjumin. Kur njeriu i hershmë flinte, shpeshë ndërron te sikur pëershruante vende dhe kryente veprime. Pas zbulimit që trupi i tij nuk e braktiste shtëpinë gjatë gjumit, ai ndeshi idenë që shpirti ose frysma e tij kishte pasur përvroat që i sillte ndërmend nga ndrra e tij.^[3]

Vështruar në rrafsh kohor, rrëfimet e Kutelit kanë përendi kryesisht të kaluarën, epoka të afërtë e të largëta, historinë e gdhendur në kujtesën e popullit, të cilën autori e gjurmon, e qartëson, e interpretion dhe e pëershruan. Ajo vjen nga mitologjia, përmes qeniesh e bëmash të jashtëzakonshme, si pjesë e mjegulluar e historisë dhe shpaloset në ngjarje e figura të qarta; flet për kohën e Skënderbeut dhe të Bendo Shapërdanit; pëershruan epokën e madhe të Rilindjes, evonon ndodhi të luftëraje ballkanike e asaj botërore dhe ndalet në kufijtë midis dy kohërave, kur mbyllen përpjekjet për një Shqipëri të lirë dhe një zhënjimi i popullit dhe urrejtja e tij ndaj pushtetit të bejlerëve.^[4] Edhe kur merr ngjarje që e kapërzëjnë këtë kufi, ato tregohen më shumë si nodhi të së kaluarës.

Brenda tekstit kutelian, e integruar në gjëresinë ideomatike dhe interpretative të krejt rrëfimit, është tema e vdekjes. Mund të pohosh se Kuteli është një lloj i veçantë i tregimtarit modern, që bashkon fantazinë dhe perceptimin folklorik me kulturën shkrimore biblike, për të na rrëfyer vdekjen në një variant sa mitik e profetik, aq edhe bashkëkohës. "Të gjitha tregimet, që nisin e vazhdojnë në mëngjes, përfundojnë me vdekjen, dhe ai nuk do të ishte tregues i vërtetë i tregimeve nëse do ta mbante të larguar nga ju".^[5]



Pothuajse në të gjitha rrëfimet e këtij prozatori, është e pranishme vdekja si shqiptim, si hije, si vegim, si prishësi, si realitet; por disa prej tyre përpjken të kapin një kuptim më esencial të vdekjes, që lidhet sa me perceptimin populor, që vendos përmes fantazmagorisë një urë lidhëse midis dy botëve, nëpërmjet një udhëtimi që sot do ta quanim udhëtimi astral i shpirtrave, duke u përpjekur të jalin mallin e të vdekurve për të lënë pas, duke u kthyer herë në hyj të bardhë, herë në lugat, herë në flutëra që vijnë e gëndohen në parvazet e drithareve të shtëpive të tyre, si një urë e fundit e lidhjes me botën e të gjallëve ... Ndërsa, pjesa që është akoma më interesante është bërë objekt i shumë studimeve mbi Kutelin, pikërisht pritshmëria e vdekjes si amshim, si shpëtim, si fund i përsosur, ku shpirti i çliruar nga mëkatet tenton të bashkohet sa më parë me krijuesin e tij dë të kthehet domosdoshmërisht te burimi prej nga u nis, për t'u strehuar përkohësisht në një trup njerëzor ...

Rrafshi i parë konceptual mbi vdekjen, sipas perceptimit mitik populor, shfaqet kryesisht tek I vdekuri dhe i gjallë, i cili është ndërtuar përafërsisht sipas modelit të përrallës popullorë I vdekuri lan borxhet, me disa ndryshime në rrafshin e thurjes së ngjarjes dhe narracionit, si dhe te Rime Kateriniza, e ndërtuar sipas motiveve të përrallës së Mimikaliut. Ky perceptim mitik shfaqet edhe te disa rrëfime të tjera, si te Të vdekurit dhe Lugëtarët e fshatit tonë. Këtu kemi një dialog mes dy botëve, një komunikim shpirtëror ku të dy palët, pasi provojnë realitetin e këtij dë të andejshëm, fatkeqësisht përfundojnë në botën andej varrit; madje edhe fluturat, pasi enden një fare kohe në këtë botë, befas zhduken.

Në rrafshin e dytë konceptual të vdekjes, do të përfshinim kryesisht rrëfimin Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit dhe novelën E madhe është gjema e mëkatit. Ndërsa elemente të pjesshme të ndërtimit të këtij kuptimi të vdekjes mund të gjëjmë, jo rrallë, edhe në rrëfime të tjera të tij. Këto nuk janë thjesht për të zbuluar domosdoshmërisht kuptimin e vdekjes, por për të theksuar mirësinë njerëzore, lirimin e shpirtit dhe përgatitjen e tij për

të shkuar te krijuesi përmes veprimit të mirëbërëse në dobi të komunitetit, si Papu Tira, i pasuri dhe ish i varfër, Latir Kulira.

Në këtë rrafsh, vdekja kërkohet për individin kryesisht në spektrin e komunikimit me hyjnoren, si provë që tregon shkallën e fundit të stoicizmit të brishtë të qenieve humane dhe pafuqinë e tyre para përfjetësisë në këtë botë.

Një lidhje të ndërmjetme gjemjë midis këtyre rrafsheve kuptimore të vdekjes, atëherë kur ndarja futet si pjesë integrale e rrëfimit dashuria, e cila bëhet shkaku që të vdekurit të rikthesh përkohësisht në këtë botë (Rinë Katerinëza dhe Lugëtarët e fshatit tonë), apo kur dashuria tokësore kthehet në një ndëshkim për të kapur përfjetësinë (Tat Tanushi i Bubëtimes). Ky ndërveprim i erosit me tanatosin; dy instinkte bazë të njeriut sipas Frojdit, bëhet për arsyen se koncepti i lumturisë dhe i dhimbjes njëherësh, në gjithë letërsinë e shkujve.

Dashuria është lidhur pazgjidhshmërisht me dy aspekte: dashuria si lumturi që i përket jetës tokësore dhe dhimbja që i përket shpirtit. Kjo lidhje detyrimisht krijon një urë që mban të lidhura dy botë krejt të kundërtat. Njerëzit enden midis këtyre dy kahjeve, duke kaluar nëpërmjet ndjenjave që quhen ndjenja. Prandaj, Leopardi në një nga kantot e tij shprehet:

Kur për herë të parë
në thellësinë e zënies lind dashuria

Mundshëm dhe ngadalë, bashkë me të depërtón
në zemër dëshira e vdekjes
Pse? S'e di, por kjo
është shenjë e pagabueshme e
pasionit të vërtetë.

Në rrëfimet e tipit të parë, siç pohuan më sipër, autori vendos një dialog mes dy botëve. Shkaku i këtij korrelacioni fantazmagorik është ose mbajtja e fjalës së dhënë, ose dashuria, ose mall për të dashurit e gjallë. "Bashkimi i Rinisë së gjallë me Kirillojin e vdekur, dashuria e Tat Tanushit me Kaljen, bashkimi në greminat e ligë të vajzës së 'krahëve të bardhë' me Pjetër Kulirën etj., përfaqësojnë përpjekjen e dyanshme të dy shpirtrave të ndarë nga vdekja".^[6]

Ky koncept i bashkimit përpjeket të sjellë tjetrin në solidaritetin e kësaj bote, duke pasur parasysh se ai ka veshur vetë ... Kjo përbën mendësinë rrëth së cilës sillet proza e tij rrëfimtare. Lindja mitologjike në veprat e Kutelit ka veshje etnike, por kumti i saj është universal. Ashtu si gjenia e përvjës së krijimit gojor, Kuteli synon drejt përshtaqjes së asaj që ka të bëjë me esencën, me energjinë e përbashkët që i bashkon njerëzit në një letër. Kjo energji

të jetëve dhe është pikërisht energjia universale.

Në disa studime të antropologjisë kulturore, drejtohet vëmendja tek mënyra se si njeriu komunikon me hyjnoren. Njeriu i drejtohet Zotit përmes lutjeve, sakrificash, përmes pjesëmarrjes në modele, ndërsa hyjnoria i adresohet njerëzores përmes mrekullish, ose èndrrës. Mesazhi hyjnор i jepet Ago Jakupit përmes èndrrës: deri në fundin e jetës së tij, atij i jepet mundësia të shpëtojë shpirtin në raport me Zotin. Èndrra ishte kodi që zbërthen dhe realizon Ago Jakupi në jetë për të marrë statusin e të përkohshmit; dhe pasi realizon katarsisin, ai shkon të shtrihet në derësat e arkëmortit që kishte përgatitur vetë: "Dhe u shtua në të shumtë". Ky është fundi sipas A. Plasarit: vdekja si fillim absolut, si fund i përsosur, si zanafilla dhe thelbi i jetës, si e shkuara dhe e ardhmja e së tashmes.^[7]

Këtë, Kuteli e realizon plotësisht si Janushi i Bubëtimes, mesazh të shumëfishuar të gjithë procesit të tij të Tat. Toni religjioz ngjizet prej shenjash gjuhësore përmes përgjedhjes së personazheve. Në një moment, Tata, duke i dhënë një rëndësi absolute dashurisë tokësore, prish drejtpeshimin e universit, të raportit të gjenisë me Zotin dhe kjo sjell pavdekësinë. Por, jeta njerëzore, sipas një projekcionit gjenial, nuk e rok dot mendja njerëzore, pasi mundimet e njeriut duhet të mbarojnë. Këtu dënim i vdekjen përkthehet në mundim pa fund, në një mënyrë si në mitin e Sizifit. Nga marrëdhëni e dy instinkteve bazë kuptuar si dy domosdoshmëri bazë, eros dhe thanatos, autori projekton kalvarin e jetës njerëzore. Ai i ka vendosur ngjarjet sipas një lëvizjeje fikionale ku vdekja e Kalijes dhe dashuria shënojnë dy nyje narrative ku përshtruhet gjithë linja narrative. Proza, përmes plasticitetit të frazës, sjell tek receptuesi ndjesinë e amshimit përmes përshtakimeve të situatave dhe objekteve me ngarkesë fetare.

[1] Hermann Hesse, *Der Steppenwolf* (Suhrkamp Verlag, Frankfurt am Main), cituar sipas përkthimit në gjuhën shqipe: Herman Hesse, Ujku i stepës, përkthyer nga Arbëri Çeliku, "Asdreni", Shkup, 2010, fq. 171.

[2] A. Smyth, *National Identity* (London, "Penguin", 1991), fq. 6.

[3] Lowell D. Holmes, *Anthropology: An Introduction* (The Ronald Press Company, New York), 1965, faqe 240.

[4] Miroslav Markaj. Vende dhe njerëz në veprën e M. Kutelit (Kumtesë mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 80-vjetorit të M. Kutelit. Pogradec, tetor 1987).

[5] Ernest Hemingway te Vdekje pasdite (Tiranë, 2002), fq. 19.

[6] Plasari A., Kuteli mes të gjallëve dhe të vdekurve (Prishtinë, 2000), fq. 82.

[7] Po aty, fq. 93.

Trump dhe rendi i kaosit: Fati i botës i lidhur me një njeri



Lucio CARACCIOLI

Jetojmë një epokë kaosi me teprí, e shkaktuar nga kriza e njëkohshme e Superfuqisë Nr. 1 dhe sfiduesve të saj. Amerika, Kina dhe Rusia ndihen të kërcënua në ekzistencën e tyre. Kur një shtet arrin në këtë shkallë të vetëdijes, e konsideron veten të gjallë vetëm njështë superfuqi. Nëse "zbret" një nivel më të ulët, tundohesh nga vetëshkatërrimi (siç tregoi shembulli i Bashkimit Sovjetik). Dorëzohesh.

Kështu po lind Lufta e Madhe në disa fronte, të nxehta ose të vakëta, e cila, njës nuk ndalet, mund të shndërrohet në një luftë tërësisht globale. Kaosi krijon boshllëqe që tërheqin ambiciozët. Perandori të vjetra, dikur të shpallura të pafuqishme (si Turqia dhe Japonia), ish-koloni që tashmë e shohin veten si shtete-qytetërim (India/Bharati), apo vende të poshtëruara që po rimëkëmben falë dobësimit të fqinjëve të tyre (si Polonia), po përpilen të rindërtojnë statusin e tyre në arenë ndërkombëtare.

Hegemonia po kalon nga Amerika, tek kaosi. Kjo do të zgjasë për një kohë të gjatë. Një kolos i paprecendentë nuk shembet brenda natës, veçanërisht kur është një gjendje të tërheqë në katastrofë edhe pjesën tjetër të botës. Dhe kur Amerika të vendosë se koha e saj kambaruar, dëshira e saj e fundit do të jetë të parandalojë që dikush tjetër të zërë vendin e saj.

Amerika po lufton me veten. Për të mbijetuar, ajo e di se duhet të shërojë plagët e brendshme nëpërmjet ndërvëprimit me botën – por vetëm pasi të ketë rivendosur "rendin natyror të gjërave": "Ne përpara, të tjerët pas, ose kundër nesh." Kjo është bindja e kombinimit të ri të elitave post-liberale dhe manjatëve teknologjikë pa skrupuj, një aleancë anarko-autoritare, e mbështetur nga zemërimi i klasave të mesme dhe të ulëta, të frustruara nga globalizimi, nga "pushtimi" i të huajve të pa-asimilueshëm në kulturën WASP, dhe nga rënia e standardit të tyre të jetesës.

Kjo aleancë e çuditshme ka gjetur kampionin e saj tek Donald Trump. Ai është

profeti i "arsyes së shëndoshë", brutal në logjikë dhe në veprim. Ai mishëron "simplifikuesin e tmerrshëm", një figurë demagogjike që Jakob Burckhardt e përmendte me frikë në fund të shekullit XIX. Ai përqafon filozofinë e Trasimakut nga Republika e Platonit: "Drejtësia nuk është gjë tjetër veçse interes i më të fortit" (Libri I, 339c).

Trump e quan veten një "gjeni shumë të qëndrueshëm". Ai beson se u shpëtua nga Zoti, i cili shëngani plumbin me të cilin "shteti i thellë satanik" donte ta eliminonte. Historia do të tregojë një ka të drejtë. Por për momentin, duhet pranuar se ka diçka gjeniale në mënyrën e tij të thjeshtuar dhe të pamëshirshme të të vepruarit.

Trump 2.0: Rebeli

Mënyra se si ai nis mandatin e dytë është spektakolare dhe kaotike njëkohësisht. Amerika është e sëmurë dhe kërkon kura të rezikshme. Nëse ka një shans për shërim, do të duhet kohë. Por një president gati 80-vjeçar, me vetëm katër vjet

mandat përparrë – njës nuk e rishkuar Kushtetutën për të shpikur një mandat të tretë – e ka me nxitim.

Ai rifillon nga mitologjia amerikane, nga dëshira përtë bërë Amerikën "sërisht të madhe". Për Trumpin, të duash është të mundesh. Dëshira përsukses është po aq e rëndësishme sa vetë fuqia. Ai synon të rikrijojë një "destin 2.0". Kjo kërkon një kufi të ri përtë pushtuar. Një metavers operacional.

Prandaj, dominojnë këto prioritete: Hegemonia në Hapësirë, përtë kontrolluar Tokën dhe përtë emocionuar publikun me endrrën e kolonizimit të Marsit, pëtë promovuar nga Elon Musk; Lidershipi në Inteligjencën Artificiale, përtë dominuar kibernetikën, përtë udhëhequr revolucionin teknologjik dhe përtë ringritur industrinë mbi parime të reja – por pa i zbuluar shumë shpejt, përtë mos larguar punëtorët e kualifikuar; Shuarja e konflikteve në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, si përgatitje përluftërat e së ardhmes, të cilat janë vetëm një fillimet e tyre. Idealja do të ishte shembur establishmenit e qendrës.

Ndërkohë, administrata e Bidenit, e reduktuar në një hologram, po shijon një pushim të pamerituar. Burokracitë federale dhe shtetet e udhëhequra nga demokratët kanë hyrë në luftë guerile, të mbështetura nga segmentet më të ashpra të aparatit shtetëror.

Rezultati? Një luftë civile me intensitet të ulët. Dhe në qendër të kësaj drame është një njeri: Donald Trump. / La Repubblica – Bota.al



Grumbullohet Kosova U17

PEJË, 9 SHKURT - Të dielën në Banjë të Pejës ka nisur grumbullimi i hendbollisteve të Kombëtares U17 të Kosovës. Kombëtarja jonë e 17-vjeçareve do të paraqitet

në Kampionatin Mesdhetar që mbahet prej 17 deri më 22 shkurt në Podgoricë të Malit të Zi. Ky kampionat është shumë i fortë, me Kombëtarë cilësore, por edhe shumë i

rëndësishëm për zhvillimin e mëtejme të kësaj gjeneratë. Vajzat tona janë të vetëdijshme për rëndësinë e prezantimit dinjitoz, ndërsa shtabi teknik është i



Prishtina ndahet baras me Suharekën, Gjilani mposhti Llapin

PRISHTINË, 7 SHKURT - Në kuadër të javës së 19-të të Albi Mall Superligës së Kosovës, u zhvilluan dy ndeshje interesante. Në stadiumin "Fadil Vokrri", skuadra e Prishtinës dhe ajo e Suharekës ndanë pikët në një barazim 2-2. Leotrim Kryeziu kaloi Prishtinën në epërsi në minutën e 37-të, ndërsa Suhareka barazoi në minutën e 44-t me autogolin e Ardiq Limanit. Në pjesën e dytë, Mevlana Zeka e çoi Suharekën në epërsi në minutën e 56-të, por Leotrim Kryeziu shënoi golin e dytë personal dhe të barazimit për Prishtinën në minutën e 80-të. Pas këtij

barazimi, Prishtina renditet e katerta me 28 pikë, ndërsa Suhareka e pesta me 26 pikë. Në ndeshjen tjeter, Gjilani arriti një fitore të rëndësishme në udhëtim ndaj Llapit me rezultatin 0-1. Golin e vetëm të ndeshjes e shënoi Sabit Bilali në minutën e 61-të. Llapi pati shumë raste shënimis por nuk arriti të gjej rrugën e golit. Me këtë fitore, Gjilani ka 24 pikë dhe renditet në mesin e tabelës, ndërsa Llapit ka vetëm 18 pikë dhe është parafundit. Liderja e Albi Mall Superligës së Kosovës, Drita, e ka nisur pjesën e dytë të garave me fitore, duke e mundur Malishevën, me

rezultat 2:0, në ndeshjen e zhvilluar të premten, në kuadër të javës së 19-të. Përballë tifozëve të vet, Drita tregoi paraqitje më të mirë gjatë pjesës së dytë, kur edhe e geti rrugën e golave. Besnik Krasniqi ishte hero i ndeshjes, duke shënuar dy herë në minutat 61 dhe 78. Me këtë fitore, Drita ka arritur në kuotën e 43 pikëve, ndërkohë që Malisheva qëndron e treta me 30 pikë. Në anën tjeter, kampioni në fuqi, Ballkani, e kanë nisur stinorin pranveror me fitore 1:0 kundër Dukagjinit në Suharekë. Pas një ndeshjeje të luftuar, goli i fitores erdhë në minutën e

fundit të kohës shtesë, me autor Sunday Adetunji. Me këtë triumf, Ballkani arrin në kuotën e 36 pikëve në vendin e dytë, ndërsa Dukagjini mbetet në pozitën e shtatë me 21 pikë.



Behije Mustafa fiton medaljen e argjendtë në Evropianin e karatesë

BIELSKO-BIALA, 9 SHKURT - Behije Mustafa zhvilloi lufth të fortë në finale të Kampionatit Evropian të karatesë për të reja. Por megjithatë nuk e fitoi të artën. Të dielën pasdite në Bielsko-Biala të Polonisë, Mustafa fitoi medaljen e argjendtë në grupmoshën U21, në kategorinë deri 68 kilogramë. U mposht në finale nga gjermania Hannah Riedel. Mustafa ishte në epërsi 1:0 e më pas edhe 2:1. Lufta ishte e fortë deri në fund, ndërsa përfundoi 4:4. Për shkak të rezultatit të barabartë, fituesja u shpall me vendim të gjyqtarëve. Tre gjyqtarë anësorë e vlerësuan fituese gjermanen e njëri xhudisten kosovare. Behije Mustafa e kishte



pëparësinë që realizoi pikë e para, por e penalizoi fakti që mori dënim nga referi në arenë në 15 sekondat e fundit. Dhe kjo ishte vendimtare. Medalja e argjendtë megjithatë është sukses i madh për karatesten kosovare. Ajo i shënoi katër

fitore të shtunën për të arritur në finale. Mposhti karateiste nga Franca, Serbia, Danimarka e Turqia. Mustafa ka edhe një medalje bronzi nga Evropiani për të rinj, në vitin 2021. Kishte fituar të bronztën për grupmoshën e junioreve.

Çifti Vitaku në ndeshjen derbi të Ligës Evropiane

PRISHTINË, 9 SHKURT - Çifti i gjyqtarëve të FHK-së, Arsim Vitaku e Erdoan Vitaku, ka pasur tjetër angazhim evropian në fundjavë. Të shtunën dyshja Vitaku drejtoi ndeshje në Poloni, në kuadër të Ligës Evropiane për hendbolliste. Ndesha ishte e fazës grupore, ndërsa vuri përballë skuadrën polake Zaglebie Lubin dhe atë

gjermane Blomberg-Lippe. Fitore me rezultat 29:27 shënoi skuadra polake Lubin. Ishte kjo kryndeshje e Grupit C. Blomberg-Lippe mbetet në vendin e parë me gjashtë pikë, sa i ka tani edhe Zaglebie Lubin në vendin e dytë. Delegime të gjyqtarëve dhe delegatëve kosovarë në ndeshjet evropiane do të ketë edhe në javët e ardhshme.



Mavraj habitat me Lilë, që gjëzohet për Evopianin Shqipëri - Serbi

TIRANË, 9 SHKURT - Ish-kapiteni i Shqipërisë, Mërgim Mavraj, i ka reaguar Andi Lila, kur ky i fundit po i gjëzohej

bashkëpunimit FShF - Serbi, për Evopianin U21. Mavraj i ka komentuar Lilës në postimin e këtij të fundit për vendimin e

UEFA-së për t'i dhënë të drejtën e organizimit të Evopianit U21, Shqipërisë bashkë me Serbinë, në vitin 2027. "Seriozisht?",

pyetet Mavraj duke i komentuar Lilës, në formë çuditëse se si Lila thotë se është krenar për këtë vendim.





KOMPANIJA REGIONALE MBETURINAVE "Ambiente" Sh.A. PEJË
"Ambiente"
 NR. 267
 DATA 07.02.25

Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambiente" Sh.A. Pejë
 Me adresë Rr. Xhem Sadrija nr. Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8, dhe në bazë të Udhizimit Administrativ MRPT- NR 01/2024, Kryeshef Egzekutiv i Kompanis Regionale te Mbeturinave "Ambiente" Sh.A. Pejë me datë 10.02.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës:

KONKURS

Pozita : Mbledhës i borxheve (Inkasant) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë

Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.

Koefficient i pagës : 1.7

Përshtkimi i detyrave dhe përgjegjësive të punës:

1. Obligohen që në terren të silljet korrekt dhe të ketë të veshur uniformë dhe shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambiente Sh.A;
2. Dërgon fakturat e printuara mësore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në fakturë duhet ta kthej në rillogaritje (korrigim) tek shefi i fakturimit dhe inkasimit dhe arkëton pagesat më bllok të vërtetuar nga ndërmarrja;
3. Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasivizimet, korrigimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon tek shefi i inkasimit dhe fakturimit;
4. Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek fakturistët;
5. Në bazë të raportit të lëshuar nga fakturistët (Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitike), kontrollon reportin së a janë në përpunje me pagesat në blloku e dorëzuar dhe pasi që janë të gjitha në rregull bën dorëzimin e mjeteve në arkë;
6. Pas dorëzimit të mjeteve në arkë, nënskruan mandat arkëtimi të dokumentit dhe atë urdhër e ruan për barazim mënyra e inkasimit dhe fakturimit;
7. Jep përgjegjësi për çdo dëfshëfës të lëshuar nga blloku i tij me numër serik;
8. Jep përgjegjësi për çdo fakturë të dyfishuar dhe çdo formë tjetër, ku dëmtohet buxheti i ndërmarrjes;
9. Kryen punë bazuar në kontraten e punës, por edhe punë të tjera me urdhëresë të shefit të inkasimit dhe fakturimit;
10. Është i detyruar të zhatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregulat e caktuara nga ndërmarrja, ku përfshihet procesi i punës dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
11. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtëpërdrejt, Kryeshef Ekzekutiv.


a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e vecantës (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
- Përparrësi përvjohje pune e dëshmuar;
- Ai / Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit: Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
 Data e për aplikim është nga 10.02.2025 deri me 25.02.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakomplektuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet originale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar përfshihen në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje përi intervistë



[facebook](#)

www.facebook.com/gjejpuneshperte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Saranda Gjonaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11.12 dhe diplomën e certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplekt, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA
1992





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

